

KESHILLI MINISTRUESH

Vendi i...

Nr. 101 me 12.11.1931

17

Keshilli Ministruesh ne mbledhjen e tij te sotshme te mbajtur nen Kryesin e Z. Pandeli Evangjeli, Kryeminister e Zv. Ministri i r. te Jashteme, me antar Z. Pandeli Avllari, Ministri i Drejtesis, Misa Juka, Ministri i r. te Brendshme, Hil Haxhi, Ministri i Arcsinit, Kol Thaqi, Ministri i Financave, Met Dibra, Ministri i P. Botore Mehdi Frasherit, Ministri i Ekonomia Kombetare, me pare ne bisedim shkresen Nr. 155/I date 7. I. 1931, te Ministria ne Financave me te cilen tregon se, nderhyrjet dhe pervantimet me te shumta q' i bahen pasunis se Shtetit ne qarkun e Durresit rrjedhin pas n'ate qark mungojshin krejt regjistrat e pasunive Shtetnore, dhe nga kjo mungese grabitja e tokave ka arrijte sa ne kete vjet e treta e qifligjeve ka mbet pa u shite, e se Kontrollor'i Pasunis se Shtetit dhe i kadastrave ne kerkimet qe ka bere ne magazinat e akteve te vjetra te durresit ka mund me gjete regjistrat te doros se pare q' i permbajne gjith pasunit e pa tundeshme te qarkut-Durres-Shijak, me te tane cilesit kadastrave bazim ne kohet e qeveris provizore te Esat Toptanit ne vjetin 1915 dhe te vertetshme regullisht prej komisionit te formuar per kete qellim e prej Pleqesis te katundeve, e se si mbas propozimit te tij po te vertetohen keto regjistrat kane me qene valabel e kan me qite ne sheshte gjith pasunit Shtetnore te grabituna prej privateve, vendosi pranimin e ketij propozimi dhe vlefshemnin e regjistrave ne fjale tue autorizue Ministrin e siper-permendur me vue dore mbi gjith pasuniet Shtetnore te shenueme ne keto regjistrat, tue mos' i marre parasysh dokumentat e aktet e krijueme mbas dates se ketyne regjistrave, e tue i lane keto te lire me ju drejtue gjyqit per q' do te drejte qe mund te pretendojne mbi ata pasuni.

Sekretar i Perqijitshem:

T. Selencia d.v.

88xh "

LEJDA E KESHILLIT MINISTRUESH

Nr. 55

Tirane, me 14 Prill 1931.

Ministria se Financave

Tirane.

Per dije e veprim ju dergohet kopje e siperme e vendimit te Keshillit Ministruesh.

KRYE MINISTRI: Pandeli Evangjeli d.v.

Vertetohet se asht nji me origjinalin Kontrollor'i I-re i Pasunivet Shtetnore:

